

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® ViscoCrete® Techno-15+

ADITIV SUPERPLASTIFIKUES I GJENERATËS SË RE PËR BETONIN



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® ViscoCrete® Techno-15+ është një aditiv betoni, i gjeneratës së re, i fuqishëm dhe superplastifikues.

### PËRDORIMET

Sika® ViscoCrete® Techno-15+ bazohet në teknologjinë e polimereve polikarboksilate. Ofron reduktim të madh të ujit dhe aftësi të madhe rrjedhshmërie fillestare për përzierjet kërkuese të betonit. Përdoret në rastet e mëposhtme:

- Kërkesë për reduktim të madh të ujit tek përzierja e betonit
- Kategori e lartë rezistence e betonit të gatshëm dhe betonit të prodhuar në kantier
- Punueshmëri e shtuar e përzierjeve prej betoni edhe në dozë të ulët
- Prodhim betoni me kërkesa të larta & cilësi
- Beton me kategori konsistence S4 / S5 dhe kohezion të shtuar

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sika® ViscoCrete® Techno-15+ është një superplastifikator i fuqishëm i cili ofron punueshmëri fillestare shumë të lartë të përzierjes dhe jo vetëm:

- Ofron kategori konsistence (slump) S4 & S5, edhe tek betoni me raport U/Ç shumë të ulët
- Prodhon beton me rezistenca fillestare dhe përfundimtare të larta
- Betoni i ngurtësuar ka tkurrje të reduktuar
- Sika® ViscoCrete® Techno-15+ nuk përmban klorure, gjë që e bën të përshtatshëm për beton të parandëruar dhe të armuar

### MIRATIME / STANDARDE

Aditiv reduktues në shkallë të lartë i ujit / superplastifikues (Tabelat 3.1 & 3.2) sipas EN 934.02:2009+A1:2012, Deklaratë Performance 27566269 dhe mbart markën CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Solucion ujqor i polimereve polikarboksilate
Ambalazhi	IBC, fuçi 220 kg, bidon 20 kg. Furnizim rifuqxo me porosi.
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, kafe e lehtë
Jetëgjatësia	8 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin fillestar, të mbyllur dhe të vulosur, në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Mbrojeni nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~1.04 Kg/l (në +20°C)
Vlera e pH	3.5 – 5.5 (në +20°C)
Përmbajtja totale e joneve të klorurit	Nuk ka (EN 934.01)

## TË DHËNA TEKNIKE

### Udhëzime për betonimin

Gjatë betonimit duhet të zbatohen rregullat standarde për sa i takon prodhimin dhe vendosjes së betonit. Referohuni tek standardet përkatëse. Betoni i freskët duhet të trajtohet në mënyrë të përshtatshme.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

### Doza e rekomanduar

0.3 – 2.0 % për peshë çimentoje

### Kompatibiliteti

Sika® ViscoCrete® Techno-15+ mund të kombinohet me produktet e mëposhtme Sika:  
- Seria Sika® Plastiment®  
- Sika® Plastocrete® N/ Sika®-1+ / Sika® WT-200 P  
- Sika® Visco I-100  
- Sika-Aer® Fine  
- SikaRapid®-2  
- Sika® Ferrogard®-901 S  
- Sika® Antifreeze  
- Sikafume® HR-E / Sikacrete® AR  
- Akseleratorët për torkret Sigunit®  
Rekomandohet të kryhen testime përpara kombinimit të produkteve.

### Mënyra e aplikimit

Sika® ViscoCrete® Techno-15+ shtohet në ujin e përzierjes në fabrikë ose direkt në betoniere.

### Kufizime

- Përdorimi i Sika® ViscoCrete® Techno-15+ duhet të bëhet bazuar në një recetë të miratuar dhe burimet lokale të lëndëve të para duhet të testohen.
- Sika® ViscoCrete® Techno-15+ nuk duhet të shtohet në çimento të thatë.
- Sika® ViscoCrete® Techno-15+ duhet të shtohet bashkë me ujin e përzierjes ose shtohet tek betoni në fund të procesit të përzierjes.
- Përpara zbatimit duhet të kryhen testime përshtatshmërie.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® ViscoCrete® Techno-15+  
Maj 2019, Botimi 02.01  
021301011000002130

SikaViscoCreteTechno-15+-sq-AL-(05-2019)-2-1.pdf